

CRNA GORA
MALI I ZI
SKUPŠTINA OPŠTINE ULCINJ
KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT
BR./NR. 02-238/19
Ulcinj,Ulqin më 30. 10. 2019

**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E PARË E SEANCËS SË DYTË TË RREGULLT TË
KUVENDIT TË KOMUNËS SË ULQINIT**

Mbledhja është mbajtur, më 28. 10. 2019 duke filluar në orën 12:00.

Në mbledhje marrin pjesë të gjithë këshilltarët përveç: Arsim Cuca, Gazmond Kaleziq, Arijan Murati, Xhelal Dervishi, Majlinda Duraku, Luigj Shkrela dhe Haki Mavriq.

Kryetari i Kuvendit thekson që në pajtim me nenin 84 të Rregullores, kanë lajmëruar që nuk mund të marrin pjesë në mbledhje këta këshilltarë: Arsim Cuca, Arijan Murati, Xhelal Dervishi, Majlinda Duraku dhe Haki Mavriq.

Pas konstatimit që ekziston kuorumi Kryetari në pajtim me nenin 86 të Rregullores hapën debatin lidhur me miratimin e procesverbalit nga mbledhja e tretë e seancës së parë të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ulqinit, mbajtur, më 29 dhe 31. 07. 2019, duke theksuar që në sajtin e Kuvendit janë publikuar video dhe audio regjistrimet nga kjo mbledhje. Pasi që nuk ka pasur vërejtje Kryetari konfirmon që procesverbali nga mbledhja e tretë është miratuar pa vërejtje.

Pastaj Kryetari ka lexuar rendin e ditës ashtu siç është në thirrjen numër 02 – 238/19 të datës 14. 10. 2019 dhe propozon që në rend të ditës të futet propozimi Vendimi për emërimin e sekretarit të KK Ulqin pasi që për këtë pikë u është ndarë materiali këshilltarëve dhe konstaton që për pikat 9, 10 dhe 11 të rendit të ditës të propozuar nuk ka material dhe hapën debatin në lidhje me rendin e ditës.

Ardijan Mavriq shtron pyetjen se pse këshillat nuk e kanë shqyrtuar nismën qytetare dhe pse nuk është në rend të ditës të mbledhjes së sotme dhe propozon që kjo nismë të futet në rend të ditës.

Kryetari i Kuvendit Ilir Çapuni shpjegon që Shërbimi i Kuvendit ia ka dorëzuar nismën qytetare këshillit kompetent si dhe ekzekutivit por nuk kemi fituar asnjë mendim siç është e paraparë me Statut.

Ardijan Mavriq thekson që këshilltarët kanë pasur kohë që ta shqyrtojnë këtë inisjativë dhe thekson që ne si këshilltarë kemi të drejtë ta propozojmë këtë pikë në rend të ditës dhe nuk shih ndonjë shkak që ky propozim mos të qitet në votim.

Kryetari i Kuvendit Ilir Çapuni konstaton që këtë propozim do ta qesë në votim duke theksuar që do ta përkrahi propozimin e këshilltarit Ardijan Mavriq.

Jasmina Hasa propozon që në rend të ditës të futet propozim Vendimi për dhënien e pëlqimit për zgjedhjen e drejtorit të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Veprimtaritë komunale” Ulqin.

Naser Resulbegović kërkon shpjegime në lidhje me pikat 9, 10 dhe 11 të rendit të ditës të propozuar pasi që nuk e kemi marrë materialin për këto pika dhe është i mendimit që këto pika janë shumë të rëndësishme e veçmas pika 9 Informata për raportin e institucionit shtetëror të auditit për Llogarinë përfundimtare të Buxhetit të Komunës së Ulqinit për vitin 2019 duke theksuar që ky raport i është dorëzuar edhe Kuvendit të MZ dhe ai do të shqyrtohet në Kuvendin e MZ dhe në qeverinë e MZ që ne si këshilltarë nuk e kemi marrë këtë material edhe pse është futur në propozimin e rendit të ditës duke theksuar që ka qenë një propozim që është dhënë në kolegjum tek Kryetari i Kuvendit dhe kërkon sqarime lidhur me këtë.

Kryetari i Kuvendit Ilir Çapuni jep sqarime duke theksuar që akoma nuk është dorëzuar materiali nga ana e ekzekutivit dhe se mbesin në rend të ditës nëse e votojmë këtë propozim të rendit të ditës. Më tutje ka thënë që kur të vijnë këto pika për t’u shqyrtuar mund ta ndërpresim punën e mbledhjes dhe pas dorëzimit të këtyre informata do t’i shqyrtojmë këto pika.

Ilir Harasani propozon që në rend të ditës të futet edhe inisiativa qytetare pasi që i plotëson të gjitha kushtet ligjore.

Kryetari thekson që kemi këto propozime për t'i futur në rend të ditës të mbledhjes së sotme si:

- Propozim Vendimi për emërimin e Sekretarit të KK që është propozim i Kryetarit të Kuvendit,
- Propozimi i këshilltarit Ardijan Mavriq dhe Ilir Harasani që në rend të ditës të futet inisiativa qytetare dhe
- Propozimi i këshilltares Jasmina Hasa që në rend të ditës të futet Propozim Vendimi për dhënien e pëlqimit në zgjedhjen e drejtorit të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Veprimtaritë komunale" Ulqin.

Haxhi Sulejmani thekson që edhe ai është për iniciativën qytetare por jo në këtë mënyrë. Më tej ka shtuar që është për zgjedhjen e sekretarit të KK Ulqin dhe drejtorit të Veprimtarive komunale pasi që e kemi materialin për këto pika por për iniciativën qytetare nuk e kemi materialin. Po ashtu ka shtuar që as në këshilla nuk i kemi shqyrtuar as këto dy pika që kanë qenë të parapara në mbledhjen e jashtëzakonshme për shkak që nuk e kemi pasur dokumentacionin komplet në lidhje me këto pika.

Arijan Ljamoviq ka theksuar që kjo iniciativë qytetare nuk i plotëson kushtet që në mbledhjen e sotme të futet në rend të ditës duke theksuar që nuk jemi kundër kësaj iniciative dhe ka cituar nenin 137 dhe 138 të Rregullores.

Pas kësaj në replikë kanë marrë pjesë: Ardijan Mavriq, Haxhi Sulejmani dhe Arijan Ljamoviq.

Pastak Kryterai ka qitur në votim që në rend të ditës të futet Propozim Vendimi për emërimin e Sekretarit të KK Ulqin, Kuvendi njëzëri nga këshilltarët e pranishëm e ka miratuar propozimin e bërë. Qet në votim që në rend të ditës të futet inisiativa qytetare, Kuvendi me shumicë votash (pro 23, kundër 0, përmbajtur 1) nuk e ka miratuar propozimin e bërë. Pastaj qet në votim Propozim Vendimin për dhënien e pëlqimit në zgjedhjen e drejtorit të SHPK "Veprimtaritë komunale" Ulqin, Kuvendi me shumicë votash (pro 23, kundër 0, përmbajtur 1) nuk e ka miratuar propozimin e bërë.

Pastaj Kryetari ka lexuar rendin e ditës.

Borislav Bashoviq (proceduriale) thekson që duhet shikuar se çfarë shkruan në Rregullore në lidhje me materialet që nuk i kanë marrë këshilltarët, e është i mendimit që fillimisht duhet diskutuar për këtë që këto pika të rendit të ditës duhen hequr nga rendi i ditës e gjithashtu ka thënë që në lidhje me këtë Kuvendi të nxjerrë një përfundim të caktuar se si të vihet deri tek këto informata, kurse këshu sot që në rend të ditës të futen këto informata nuk mundet.

Kryetari i Kuvendit thekson që propozimi i këshilltarit Borislav Bashoviq që pikat 9, 10 dhe 11 të rendit të ditës për të cilat nuk e kemi materialin Kuvendi nuk mund t'i shqyrtojë, propozim i këshilltarit është që këto pika të hiqen nga rendi i ditës e që Kuvendi të nxjerrë një përfundim ku do të obligohet Kryetari i Komunës që të na i dorëzojë këto informata duke theksuar që këto informata janë propozuar në Kolegjiun e Kuvendit në prezencën e Kryetarit të Komunës.

Haxhi Sulejmani thekson që këto pika janë propozuar në kolegjiun dhe në këshillin për financa nuk është diskutuar për këto pika pasi që nuk kemi pasur material duke theksuar që pa material nuk ka shqyrtim në Kuvend dhe që duhen shqyrtuar edhe në këshilla.

Nazif Cungu thekson që pa material është e vështirë të shqyrtohen dhe që në pajtim me Rregulloren e Kuvendit mund të nxirret përfundim që në mbledhjen e parë të radhës të përgatitet materiale dhe të diskutojmë në lidhje me këto informata.

Pas kësaj Kryetari i Kuvendit qet në votim që pikat 9, 10 dhe 11 të hiqen nga rendi i ditës me përfundimin me të cilin Kryetari i Komunës obligohet që të përgatisë informatat për pikat 9, 10 dhe 11 për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit, Kuvendi njëzëri nga këshilltarët e pranishëm ka miratuar propozimin e bërë.

Pastaj Kryetari i Kuvendit qet në votim këtë

Rend dite

1. Pyetjet dhe përgjigjet e këshilltarëve,
2. Propozimi i Statutit të Komunës së Ulqinit,
3. Propozimi i aktvendimit për kompensimin e shpenzimeve për punën e Komisionit për hartimin e propozimit të Statutit të Komunës së Ulqinit,
4. Propozim Vendimi për fillimin e hartimit të Rregullores së Kuvendit të Komunës së Ulqinit dhe formimin e Komisionit për hartimin e Propozimit të Rregullores,

5. Propozim Vendimi për dhënien e pëlqimit në Vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 01-1299/19 të datës 12. 08. 2019 për shfuqizimin e Vendimit për konfirmimin e shpërblimin e njëhershëm për nëpunësit dhe zyrtarët lokalë të Komunës së Ulqinit,
6. Propozim Vendimi për blerjen e tokës me qëllim të kompletimit të parcelës urbanistike nr. 10 zona “B”, nënzona 5 PDU “Fusha e Ulqinit” – Cenaj Xhemalit,
7. Propozim Vendimi për blerjen e tokës me qëllim të kompletimit të parcelës urbanistike nr. 16 dhe 17 zona “B”, nënzona 4 PDU “Fusha e Ulqinit” – Ishmiq Melindës,
8. Propozim Vendimi për blerjen e tokës me qëllim të kompletimit të parcelës urbanistike nr. 141 PDU “Pinjeshi 3” – Rexhoviq Saljos,
9. propozim Vendimi për emërimin e Sekretarit të Kuvendit të Komunës së Ulqinit dhe
10. Propozim Vendimi për dhënien e pëlqimit në emërimin e drejtorit të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Veprimtaritë komunale” Ulqin.

Kuvendi njëzëri nga këshilltarët e pranishëm e ka miratuar.

Pika 1 Pyetjet dhe përgjigjet e këshilltarëve

Kryetari i Kuvendit thekson që në mbledhjen e kaluar janë parashtruar disa pyetje, por që nuk kanë marrë përgjigje.

Borislav Bashoviq thekson që në lidhje me pyetjet dhe përgjigjet e këshilltarëve nuk ka asgjë të re në Statutin e ri, krejt ka mbetur si ka qenë. Më tej ka thënë që shumë komuna me rastin e hartimit të Statutit për shkak të një raporti të tillë e kanë vërejtur këtë problem dhe ata e kanë definuar në këtë mënyrë që të mbahet një mbledhje e posaçme në të cilën do të ftohen Kryetari i Komunës dhe sekretarët që të përgjigjen menjëherë në pyetjet e parashtruara të këshilltarëve. Ai ka parashtruar pyetjen se pse Kuvendi i Komunës si pronar i sipërmarrjes Ujësjellësi e kanalizimi e mban Statutin një kohë kaq të gjatë që akoma nuk e jep pëlqimin që kjo sipërmarrje të transformohet në SHPK, duke theksuar që muaji korrik i vitit 2013 ka qenë data e fundit për transformimin e ndërmarrjeve publike në SHPK.

Kryetari i Kuvendit Ilir Çapuni ka dhënë përgjigje në këtë pyetje duke theksuar që është e vërtetë që është dorëzuar Statuti i sipërmarrjes Ujësjellësi e kanalizimi Ulqin dhe Vendimi për dhënien e pëlqimit, por që nuk na është dorëzuar në pajtim me Rregulloren në numër të mjaftueshëm si dhe që nuk është përkthyer në gjuhën shqipe dhe për këtë arsye nuk është futur në rendin e ditës të kësaj mbledhje.

Sabri Salaj thekson që nuk ka fituar përgjigje në pyetjen e shtruar që i është parashtruar Sekretariatit për ekonomi në lidhje me pendën në Zenelej. Duke theksuar që në Rregulloren e re të KK Ulqin duhet parashikuar që të definohet saktësisht se si duhet të sillet ekzekutivi në raport me këshilltarin. Në fund ka shtuar që të gjitha propozim vendimet që do të propozohen nga ky sekretariat nuk do t'i votoj deri që të mos itoj përgjigje.

Pyetje të këshilltarit në pajtim me nenin 62 të Rregullores ka shtruar këshilltari Ilir Harasani ndërsa me gojë kanë shtruar pyetje këta këshilltarë: Eleonora Shata dhe Nela Miloviq.

Kryetari i Komunës Loro Nrekiq ka dhënë përgjigje në pyetjen që e ka shtruar këshilltari Sabri Salaj në lidhje me pendën në Zenelej duke theksuar që ka ndërmarrë të gjitha masat e duhura që penda në Zenelej të përfundohet.

Pika 2 Propozimi i Statutit të Komunës së Ulqinit

Kryetari thekson që në këtë propozim Statut të Komunës së Ulqinit janë parashtruar dy amendamente nga Ilir Harasani dhe Omer Bajraktari.

Sabri Salaj anëtar i Komisionit për hartimin e Statutit ka paraqitur fjalën hyrëse lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Bojan Gjakonoviq kryetar i Këshillit për Statut dhe dispozita ka paraqitur raportin, këshilli me shumicë votash (pro 5, përmbajtur 1, kundër 0) i propozon Kuvendit ta shqyrtojë këtë propozim Vendim, po ashtu ka thënë që anëtari i këshillit Nela Miloviq ka pasur vërejtje që vërejtja e saj që ia ka përcjellë grupit punues nuk është bartua në mënyrë adekuate ashtu siç ka thënë ajo në shkresë e ne në këshillë kemi qenë njëzëri që kërkesa e saj të përmirësohet në raportin e grupit punues, po ashtu ka shtuar që për këtë pikë të rendit të ditës janë parashtruar dy amendamente nga këshilltarët Ilir Harasani

dhe Omer Bajraktari. Këshilli njëzëri ka përfunduar që të dy amendamentet i plotësojnë normat ligjore dhe që mund të hyjnë në procedurën e kuvendit dhe që për ta votohet veçmas.

Pastaj Kryetari hapën debatin për këtë pikë të rendit të ditës.

Nela Miloviq thekson ashtu siç ka thënë kryetari i Këshillit për Statut dhe dispozita ka pasur vërejtje në raportin nga shqyrtimi publik në lidhje me këtë propozim të Statutit duke theksuar që vërejtjen e ka bërë me shkrim përmes e-mailit që fjalët e saj nuk janë bartur ashtu siç i ka shkruar. Në Këshillin për Statut dhe dispozita kërkesa e saj është aprovuar dhe është konstatuar që raporti do të ndryshohet, por raporti për arsye që ajo nuk i di nuk është ndryshuar dhe mbetën në kërkesën e saj që raporti nga shqyrtimi publik të ndryshohet sepse vlerëson që nuk ka nevojë që dikush t'i ndryshojë fjalët e saja kur ato janë dorëzuar me shkrim. Po ashtu edhe në raportin nga mbledhja e Këshillit për Statut dhe dispozita nuk është përmendur që kryetari i trupit punues e ka pranuar gabimin e tij dhe ka thënë që do të përmirësohet dhe ka kërkuar që edhe ai raport të ndryshohet.

Florim Pali ka theksuar që ka mjaft gabime gramatikore në gjuhën shqipe në këtë propozim Statut dhe ka kërkuar që në nenin 4 paragrafi 2 ku përmenden territoret e Komunës së Ulqinit që të përfshihen edhe fshati Lulaj dhe Zenelaj si dhe që të përmirësohet emri Vladimir në Katërkollë në pjesën tekstuale në gjuhën shqipe.

Agron Mehmeti ka theksuar që ky propozim Statut është shumë i rëndësishëm, duke theksuar që në vendimin në gjuhën shqipe ka vërejtje që duheb përmirësuar dhe propozon që neni 4 të bëhet njësoj si në nenin 8 të Statutit të vjetër i cili është akoma në fuqi. Po ashtu ka pasur vërejtje në nenin 9 dhe 13 ku duhet të jetë gjuha zyrtare dhe gjuha zyrtare në përdorim gjuha shqipe. Ka pasur vërejtje në nenin 26 duke theksuar që është gabim pjesën krahas mirënjohjeve dhe shpërblimeve duhet të jetë neni 22 i cili gabimisht është shkruar neni 18 në pjesën tekstuale në gjuhën shqipe, ndërsa në gjuhën malazeze është në rregull. Po ashtu ka pasur vërejtje që në nenin 41 mungon paragrafi 2 dhe kërkon që të korrigjohet dhe të jenë identike në gjuhën malazeze dhe gjuhën shqipe.

Borislav Bashoviq mendon që këtë propozim Statut duhet aprovuar sepse tashmë jemi vonuar por a duhen bërë ndryshime mendon që duhet dhe atë në shumë segmente.

Sabri Salaj i është falënderuar të gjithë këshilltarëve për sugjerimet dhe vërejtjet e bëra, ndërsa për sa i përket vërejtjes së këshilltares Nela Miloviq duhet që në procesverbal të konstatohen ndryshimet që i ka kërkuar.

Pasi që nuk ka pasur të tjerë për të diskutuar, Kryetari i Kuvendit e mbyllën debatin dhe qet në votim amendamentin e këshilltarit Ilir Harasani, e i cili ka të bëjë me emërimin e nënkryetarit të Kuvendit, Kryetari konstaton që “pro” kanë votuar 7, “kundër 5 dhe “përmbajtur” 4. Pas kësaj Kryetari e përsëritën votimin në lidhje me këtë amendament dhe konstaton që “pro” kanë votuar 9, “kundër” 6 dhe “përmbajtur” 6, duke konstatuar që ky amendament nuk është aprovuar. Pastaj qet në votim amendamentin e Omer Bajraktarit, Kuvendi me shumicë votash (pro 18, kundër 0, përmbajtur 2”), konstaton që amendamenti është aprovuar.

Pas kësaj qet në votim Propozim Statutin e Komunës së Ulqinit me amendamentin e aprovuar, Kuvendi njëzëri nga këshilltarët e pranishëm ka miratuar Statutin e Komunës së Ulqinit me amendamentin e aprovuar të Omer Bajraktarit.

Pika 3 Propozim aktvendimi për kompensimin e punës së Komisionit për hartimin e propozim Statutit të Komunës së Ulqinit

Kryetari i Kuvendit thekson që raportues për këtë pikë të rendit të ditës është këshilltari Sabri Salaj.

Sabri Salaj ka paraqitur fjalën hyrëse për këtë pikë të rendit të ditës.

Haxhi Sulejmani kryetar i Këshillit për buxhet dhe financa ka paraqitur raportin, këshilli njëzëri I propozon kuvendit që ta shqyrtojë dhe miratojë.

Kryetari hapën debatin. Pasi që nuk ka pasur të lajmëruar për të diskutuar, mbyllën debatin dhe e qet në votim Propozim aktvendimin për kompensimin e punës së Komisionit për hartimin e propozim Statutit të Komunës së Ulqinit. Kuvendi njëzëri nga këshilltarët e pranishëm ka miratuar aktvendimin për kompensimin e punës së Komisionit për hartimin e propozim Statutit të Komunës së Ulqinit.

Pika 4 Propozim Vendimi për fillimin e hartimit të Rregullores së Kuvendit të Komunës së Ulqinit dhe formimin e Komisionit për hartimin e Propozimit të Rregullores

Kryetari i Kuvendit thekson që raportues për këtë pikë të rendit të ditës është këshilltari Sabri

Salaj.

Sabri Salaj ka paraqitur fjalën hyrëse për këtë pikë të rendit të ditës dhe ka lexuar arsyetimin e vendimit të propozuar dhe për hartimin e Rregullores së KK Ulqin formohet Komisioni në përbërje:

1. Luigj Shkrelja
2. Sabri Salaj
3. Ilir Harasani
4. Besart Resulani
5. Naser Resulbegović
6. Reshit Cuca
7. Rina Kasmi dhe
8. Gjergja Pëgjonović – punë profesionale administrative.

Kryetari hapën debatin. Pasi që nuk ka pasur të lajmëruar për të diskutuar, mbyllën debatin dhe e qet në votim Propozim Vendimi për fillimin e hartimit të Rregullores së Kuvendit të Komunës së Ulqinit dhe formimin e Komisionit për hartimin e Propozimit të Rregullores. Kuvendi njëzëri nga këshilltarët e pranishëm ka miratuar Propozim Vendimi për fillimin e hartimit të Rregullores së Kuvendit të Komunës së Ulqinit dhe formimin e Komisionit për hartimin e Propozimit të Rregullores.

Pika 5 Propozim Vendimi për dhënien e pëlqimit në Vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 01 – 1299/19 të datës 12. 08. 2019 për shfuqizimin e Vendimit për përcaktimin e shpërblimit të njëhershëm për nëpunësit dhe zyrtarët lokalë të Komunës së Ulqinit.

Kryetari thekson që propozues i këtij vendimi është Kryetari i Komunës kurse përpunues Sekretariati për administratë dhe veprimtari shoqërore dhe pasi që bëhet fjalë për dhënien e pëlqimit në Vendimin e Kryetarit të Komunës nuk ka debat dhe qet në votim Propozim Vendimi për dhënien e pëlqimit në Vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 01 – 1299/19 të datës 12. 08. 2019 për shfuqizimin e Vendimit për përcaktimin e shpërblimit të njëhershëm për nëpunësit dhe zyrtarët lokalë të Komunës së Ulqinit. Kuvendi njëzëri nga këshilltarët e pranishëm ka miratuar Vendimin për dhënien e pëlqimit në Vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 01 – 1299/19 të datës 12. 08. 2019 për shfuqizimin e Vendimit për përcaktimin e shpërblimit të njëhershëm për nëpunësit dhe zyrtarët lokalë të Komunës së Ulqinit.

Kryetari i Kuvendit propozon që debati për pikat 6, 7 dhe 8 të bashkohet pasi që bëhet fjalë për të njëjtën materie kurse votimi të bëhet veç e veç.

Pika 6 Propozim Vendimi për blerjen e tokës me qëllim të kompletimit të parcelës urbanistike nr. 10 zona “B”, nënzona 5 PDU “Fusha e Ulqinit” – Cenaj Xhemalit,

Pika 7 Propozim Vendimi për blerjen e tokës me qëllim të kompletimit të parcelës urbanistike nr. 16 dhe 17 zona “B”, nënzona 4 PDU “Fusha e Ulqinit” – Ishmiq Melindës,

Pika 8 Propozim Vendimi për blerjen e tokës me qëllim të kompletimit të parcelës urbanistike nr. 141 PDU “Pinjeshi 3” – Rexhoviq Saljos

Fjalën hyrëse për këto pika të rendit të ditës e ka paraqitur Sekretari Ahmet Aloshi i cili thekson që pikën 8 e tërheq nga rendi i ditës e bëhet fjalë Propozim Vendimi për blerjen e tokës me qëllim të kompletimit të parcelës urbanistike nr. 141 PDU “Pinjeshi 3” – Rexhoviq Saljos për shkaqe objektive, ndërsa sa i përket pikave 6 dhe 7 thekson që qëllimi i nxjerrjes së këtyre vendime është aprovimi i kërkesave të personave fizikë të përmendur në vendimet për blerjen e tokës mbi të cilën Komuna e Ulqinit e ka të drejtën e disponimit me qëllim të kompletimit të parcelave urbanistike, pasi që kërkesa e tillë plotësisht është në përputhje me dispozitat pozitive ligjore.

Bojan Gjakonović, kryetar i Këshillit për Statut dhe dispozita ka paraqitur raportin. Këshilli njëzëri i propozon Kuvendit që këto vendime mund të shkojnë për shqyrtim në Kuvend.

Haxhi Sulejmani kryetar i këshillit për buxhet dhe financa ka paraqitur raportin. Këshilli njëzëri i propozon Kuvendit që këto vendime mund të shkojnë për shqyrtim në Kuvend.

Kryetari i këshillit për planifikimin dhe rregullimin e hapësirës Xhavid Hoxhiq ka paraqitur raportin. Këshilli njëzëri i propozon Kuvendit që këto vendime mund të shkojnë për shqyrtim në Kuvend.

Kryetari hapën debatin. Pasi që nuk ka pasur të lajmëruar për të diskutuar, mbyllën debatin dhe e qet në votim Propozim Vendimi për blerjen e tokës me qëllim të kompletimit të parcelës urbanistike nr. 10 zona “B”, nënzona 5 PDU “Fusha e Ulqinit” – Cenaj Xhemalit. Kuvendi me shumicë votash (pro 18, kundër 1, përmbajtur 0) ka nxjerrë Vendimin për blerjen e tokës me qëllim të

kompletimit të parcelës urbanistike nr. 10 zona “B”, nënzona 5 PDU “Fusha e Ulqinit” – Cenaj Xhemalit.

Pastaj Kryetari qet në votim Propozim Vendimi për blerjen e tokës me qëllim të kompletimit të parcelës urbanistike nr. 16 dhe 17 zona “B”, nënzona 4 PDU “Fusha e Ulqinit” – Ishmiq Melindës. Kuvendi njëzëri nga këshilltarët e pranishëm (pro 19, kundër 0, përmbajtur 0) ka nxjerrë Vendimin për blerjen e tokës me qëllim të kompletimit të parcelës urbanistike nr. 16 dhe 17 zona “B”, nënzona 4 PDU “Fusha e Ulqinit” – Ishmiq Melindës.

Pika 9 Propozim Vendimi për emërimin e Sekretarit të Kuvendit të Komunës së Ulqinit

Kryetari i Kuvendit thekson që raportues për këtë pikë të rendit të ditës është Kryetari i Këshillit zgjedhje dhe emërime Sabri Salaj.

Sabri Salaj ka paraqitur fjalën hyrëse për këtë pikë të rendit të ditës dhe ka lexuar arsyetimin e Vendimit dhe ka theksuar që Kryetari i Kuvendit për sekretar të Kuvendit të Komunës së Ulqinit propozon që të emërohet Ardit Ceka. Kuvendi njëzërit nga këshilltarët e pranishëm ka miratuar Vendimin që për sekretar i Kuvendit të Komunës së Ulqinit të emërohet Ardit Ceka jurist i diplomuar nga Ulqini.

Pika 10 Propozim Vendimi për dhënien e pëlqimit në emërimin e drejtorit të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Veprimtaritë komunale” Ulqin

Kryetari thekson që propozues i këtij Vendimi është Kryetari i Komunës, kurse përpunues Sekretariati për veprimtari komunale dhe mbrojtje të ambientit. Pasi që nuk ka nevojë për fjalën hyrëse hapën debatin.

Pasi që nuk ka pasur të lajmëruar për të diskutuar, mbyllën debatin dhe qet në votim Propozim Vendimin për dhënien e pëlqimit në emërimin e drejtorit të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Veprimtaritë komunale” Ulqin dhe atë Skender Kaleziqi spec. sci. fidanishtes nga Ulqini. Kuvendi me shumicë votash (pro 21, kundër 0, përmbajtur 1) ka nxjerrë Vendimin për dhënien e pëlqimit në emërimin e drejtorit të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Veprimtaritë komunale” Ulqin dhe atë Skender Kaleziqi spec. sci. fidanishtes nga Ulqini.

Me këtë mbledhja e parë e seancës së dytë të rregullt e KK Ulqin i ka përfunsuar punimet në orën 15:00.

Procesverbalin e hartuan:

Sekretari

Kryetari

Gjergj Pëpjonoviq

Ardit Ceka

Dr. Ilir Çapuni